

Shoqeria: "Musa Construction" sh.p.k.  
Nipt/Nuis: M44420801I  
Sarande

---

---

## KONTRATE DHURIMI

### E Kuotave te Kapitalit Te Shoqerise "Musa Construction" sh.p.k

Sot me date **07.10.2024**, ne seline e shoqerise "Musa Construction" Sh.p.k. me adrese: Sarande, Lagjja nr.4. u lidh kjo Kontrate Dhurimi e Kuotave te Kapitalit te Shoqerise, e mbeshtetur ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve Nr.1 date: 07.10.2024, si dhe ne ligjin 9901 date 14.04.2008 Per Tregetaret dhe shoqerite tregetare " (te ndyshuar), Neni 73/b, 74/2, 81 e vijues, Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Biznesit, Neni 705 e vijues i Kodit Civil si dhe Statusin e Shoqerise.

**Ne pranine e Znj. Arjana Musa** shtetase Shqiptare me date lindje: 11.10.1961, identifikuar me numer personal: G16011055L, Ortake e vetme ne shoqeri me 100 % te kuotave te kapitalit me vlere: 100,000 leke ne cilesine e **Dhuruesit**.

Dhe

**Ne pranine e Znj. Belipjana Necaj** shtetase Shqiptare me date lindje 04.09.1982, identifikuar me numer personal: I25904077L, ne cilesine e **Perfituesit**.

### Objekti i Kontrates

---

- **Znj. Arjana Musa** ne cilesine e **Dhuruesit**, me vullnet te plote dhe te lire per te vepruar, zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit ne shoqeri me vlere 100,000 leke, ka vendosur te dhuroje te gjitha kuotat qe zoteron ne shoqeri ne favor te **Perfitueses Znj. Belipjana Necaj**

- **Znj. Belipjana Necaj** ne cilesine e **Perfituesit**, me vullnet te plote dhe te lire per te vepruar, do te perfitoje 100 % te kuotave ne shoqeri me vlere: 100,000 leke nga **Znj. Arjana Musa**.

Me hartimin dhe nenshkrimin e kesaj Kontrate, kuotat e kapitalit ne shoqerine "Musa Construction" sh.p.k. me vlere 100,000 leke qe perbejne 100% te pjesemarrjes do te ndahen si me poshte:



- Znj. Belipjana Necaj behet Ortake e vetme ne ne shoqeri, dhe do te zoteroje 100 % te kuotave te kapitalit me vlere: 100,000 leke.
- Znj. Arjana Musa humbet te gjitha kuotat qe zoteronte dhe largohet nga shoqeria.
- Kjo Kontrate permban 2 faqe dhe u hartua ne 2 kopje te firmosura nga palet kontraktuese ne cdo faqe.
- Kjo Kontrate mer fuqi te plote juridike dhe ligjore pasi depozitohet ne Qendres Kombetare te Biznesit.

Palet Kontraktuese

Dhuruesi

Arjana Musa



Perfituesi

Belipjana Necaj

